





23
EDITION

TEATER III
THEATRE THREE

30 SEPTEMBER/ SHTATOR
6 TETOR/OCTOBER

SKAMPA
INTERNATIONAL THEATER FESTIVAL







GLEDIAN LLATJA

**Kryetar i Bashkisë së qytetit të Elbasanit
President i Festivalit Teatror Skampa**

**Mayor of City Hall, Elbasan
President of the Skampa Theatre Festival**

Pershendetja e Kryetarit të Bashkisë

Tashmë qyteti ynë dashamirës i kulturës, Elbasani, është mbështjellë nga atmosfera e një prej festivaleve më frymëzues në vendin tonë gjatë 23 viteve - Festivali Ndërkombëtar i Teatrit "Skampa". Një festë teatrore që rikthehet çdo vit, pa u ndalur! Pjesëmarrja e kompanive të ndryshme teatrore e shndërron këtë edicion në një mozaik të vërtetë të vlerave artistike, individualiteteve dhe identiteteve përkatës duke nxitur dialogun ndërkulturor. E vërteta është se festivali ynë teatror "Skampa" - për rreth një çerek shekulli - është bërë një ngjarje e pritshme kulturore për qytetin tonë artdashës. Ky festival, si pjesë e denjë e kalendarit artistik kombëtar vazhdon të jetë një zë i prekshëm dhe kumbues në mjedisin teatror shqiptar dhe më gjerë në rajon. Duket se pandemia nuk i pengoi këto trupa, artistët e tyre plot energji dhe dashuri të dukshme ndaj teatrit, të takohen së bashku në qytetin tonë mikpritës të Elbasanit, në këtë edicion të 23-të, duke treguar se teatri mund dhe duhet të jetojë në kohërat më të pazakonta duke dëshmuar dashuri, forcë dhe frymëzim për njëri-tjetrin. Jam i sigurt se shfaqjet që na presin për t'u parë do të jenë një manifestim shumë i natyrshëm, jo vetëm i zhvillimit të traditës elbasanase dhe turizmit kulturor, por edhe i përkatësisë në hapësirë europiane. Prandaj jo vetëm në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, por edhe si artdashës, ipërshëndes të gjithë artistët dhe trupat pjesëmarrës, si dhe nëveçanti organizatorët e këtij festivali të cilët kanë bërë një punë të shkëlqyer.

Le të festojmë!

Already our culture-loving city, Elbasan, is surrounded by the atmosphere of one of the most inspiring festivals in our country during 23 years - the International Theater Festival "Skampa".

A theatrical celebration that returns every year, without stopping!

The participation of various theater companies turns this publication into a true mosaic of artistic values, individualities and respective identities, promoting intercultural dialogue.

The truth is that our theater festival "Skampa" - for about a quarter of a century - has become an expected cultural event for our art-loving city. This festival, as a worthy part of the national artistic calendar continues to be a tangible and resounding voice in the Albanian theatrical environment and beyond in the region.

It seems that the pandemic did not prevent these troupes, their artists full of energy and obvious love for the theater, to meet together in our host city of Elbasan, in this 23rd edition, showing that the theater can and should live in the most unusual times witnessing love, strength and inspiration to people.

I am sure that the performances that await us to be seen will be a very natural manifestation, not only of the development of the Elbasan tradition and cultural tourism, but also of our belonging to the European space.

Therefore, not only in the capacity of Mayor, but also as an art lover, I greet all the participating artists and troupes, as well as in particular the organizers of this festival who have done an excellent job.

Let's celebrate!





ADONIS FILIPI

Drejtor Artistik i Festivalit Skampa
Artistic Director of Festival Skampa



Të dashur miq,

Një festival teatorr është padyshim një mozaik ngjarjesh të gëzueshme për jetën kulturore të një qyteti, vendi e përtej, që vjen si një zë shprese e besimi për të hapurportat e tij për publikun.

Në këto kohë të vështira dhe të çuditshme, ngjarje të tilla shndërrohen në simbole të dritës dhe zjarrit të cilat shërbejnë mjaftueshëm për të ndriçuar dhe ngrohur shpirtin njerëzor.

Është teatri që na lejon t'i tregojmë njëri-tjetrit dhe spektatorëve, përmes argëtimit dhe lojës së aktorëve - paradoksalisht me jetët e tyre - afrimin e një vizioni alternativ të shpresës. Kjo është e vetmjaudhë që ata të orientohen drejt, përballë gjithçkaje që nuk funksionon siç duhet në botën tonë, për të ecur përpara dhe për të bindur njerëzit të sillen ndryshe.

Ne kemi nevojë për stimuj për ekzistencën tonë artistike dhe mundësitë për t'u akorduar dhe për t'uzhvilluar më tej. Edhe ky edicion i tanishëm - "Teatër III" - ruan koherencën por shënon edhe një hap më tej në konsolidimin e klimës së nevojshme për përballimin me sukses të sfidave që afron koha, për të treguar se teatri mund dhe duhet të jetojë në kohërat më të pazakonta, duke dëshmuar dashuri, forcë dhe frymëzim për njerëzit.

Një admirues i yni londinez, mik i pandarë i Festivalit "Skampa", na nxiti ndër të tjera me një thënie nga Winston Churchill, se: "Balonat ngrihen në lartësi gjatë përballjes me erën, jo duke fluturuar bashkë me të. Uroj që balona juaj të ndeshet me erëra të forta!".

Unë kam besimin se ky festival do të vijojë fluturimin e tij!

Dear friends,

A theater festival is definitely a mosaic of joyful events for the cultural life of a city, country and beyond, which comes as a voice of hope and confidence to open its doors to the public.

In these difficult and strange times, such events turn into symbols of light and fire which serve enough to enlighten and warm the human soul.

It is the theater that allows us to show each other and the spectators, through the entertainment and play of the actors - paradoxically with their lives - the approach of an alternative vision of hope. This is the only way for them to orient themselves, in the face of everything that does not function properly in our world, to move forward and persuade people to behave differently.

We need incentives for our artistic existence and opportunities to adapt and develop further. This current edition - "Theater three" - maintains coherence but marks another step in consolidating the climate needed to successfully meet the challenges of time, to show that theater can and should live in the most unusual times, showing love, strength and inspiration to people.

One of our admirers in London, an inseparable friend of the Skampa Festival, encourages us, among other things, with a saying of Winston Churchill: "Kites rise highest against the wind, not with it. So may your kite meet with a strong wind!".

I am confident that this festival will continue its flight!



SKAMPA FEST PROGRAM 2021

30 SEPTEMBER

18:30 - Theatre Skampa - Opening Ceremony

19:00 - Art "Polis" , Pristina, Kosovo
"Totem and Taboo" by Zana Hoxha
Choreography and Directed by Robert Nuha

01 OCTOBER

19:00 - Bu Yapim Theatre , Istanbul, Turkey
"I had no voice when I woke up "
by Amy Nostbakken and Norah Sadava
Directed by Tamer Levent

20:30 - 3AT Dance, Tirana, Albania
"Nocturne on our stories"
Idea, concept and choreography by A. Ibërshimi

02 OCTOBER

19:00 - Knjizevsko-srpski Teater, Serbia
"Crying again, this time from happiness" by Novica Savic
Directed by Dragan Jakovljevic

03 OCTOBER

11:00 - Book promotion -
"A Dream of passion" - Lee Strasberg
(Adonis Filipi, Klejda Plangarica)

18:00 - Mediascena Theater, Turin, Italy
"Enigmatic variations" by Eric-Emmanuel Schmitt
Directed by Emiliano Palali

20:00 - Vilnius City Theatre Projects, Lithuania
"Now inside of me is completely another fire"
Based on S. Beckett's, Directed by Saulius Varnas

04 OCTOBER

11:00 - "Let the light of the artist reflect on the whole society!"
In memoriam Bekim Lumi, Shpetim Shmilli, Luran Ahmeti,
Slobodan Milatovic.

19:00 - Theatre Skampa, Elbasan, Albania
"A madam from Argentina" by Tomas Brand
Directed by Adonis Filipi

05 OCTOBER

19:00 - Theatre "Aleksander Moisiu", Durres, Albania
" Marriage " based A.P Chekhov
Directed by Driada Dervishi

06 OCTOBER

19:00 - Ankara State Theatre, Turkey
"Our Yunus" by Sönmez Atasoy
Directed by Mustafa Kurt

23
EDITION

TEATER III

**THEATRE
THREE**

30 SHTATOR
SEPTEMBER
6 TETOR
OCTOBER
2021

30 SHTATOR

18:30 - Teatri Skampa - Ceremonia e Hapjes

19:00 - Art "Polis" , Prishtinë, Kosovë
"Totem dhe Tabu" nga Zana Hoxha
Koreografia dhe Regjia nga Robert Nuha

01 TETOR

19:00 - Bu Yapim Theatre, Stamboll, Turqi
"U zgjova pa zë" nga Amy Nostbakken & Norah Sadava
Regjia nga Tamer Levent

20:30 - 3AT Dance, Shqipëri
"Nokturn mbi historitë tona"
Ideja, koncepti dhe koreografia nga A.Ibërshimi

02 TETOR

19:00 - Knjazevsko srpski Teater, Serbi
"Duke qarë përsëri, këtë herë nga lumturia" nga Novica Savic
Regjia nga Dragan Jakovljevic

03 TETOR

11:00 - Promovim Libri - "Një ëndërr pasioni" - Lee Strasberg
(A.Filipi, K.Plangarica)

18:00 - Mediascena Theater – Torino, Italy
"Ndryshimet enigmatike" nga Eric-Emmanuel Schmitt
Regjia nga Emiliano Palali

20:00 – Vilnius City Theatre Projects, Lituani
"Brenda meje është një zjarr tjetër" bazuar te S.Beckett
Regjia nga Saulius Varnas

04 TETOR

11:00 - Le të reflektojë drita e artistit mbi të gjithë shoqërinë!
Në kujtim të Bekim Lumi, Shpetim Shmilli, Luran Ahmeti,
Slobodan Milatovic.

19:00 - Teatri Skampa Elbasan, Albania
"Nje madam nga Argjentina" nga Tomas Brand
Regjia nga Adonis Filipi

05 TETOR

19:00 - Teatri "Aleksander Moisiu", Durrës, Albania
"Martesa" bazuar nga A.P Chekhov
Regjia nga Driada Dervishi

06 TETOR

19:00 - Ankara State Teatër - Turqi
"Yunusi ynë" nga Sonmez Atasoy
Regjia nga Mustafa Kurt

TOTEM AND TABOO / TOTEM DHE TABU

KOSOVO

ARTPOLIS – ART AND COMMUNITY CENTER
DRAMATURGJI / DRAMATURGY BY ZANA HOXHA

KOREOGRAFIA DHE REGJIA / CHOREOGRAPHY/ DIRECTED BY ROBERT NUHA

MUZIKA-PIANO / MUSIC BY ALZAN GASHI
KOSTUMET / COSTUME DESIGNER / YLLKA BRADA
NRICIMI /LIGHT DESIGNER - MURSEL BEKTESHI

“Totem dhe Tabu” është një tandem eksperimental i historive të përcjella përmes gërshetimit të vallëzimit, aktrimit, këngëve dhe humorit, duke sugjeruar se jeta sfidohet në forma të ndryshme dhe jemi ne ata që i japim ngjyrë.

Gjetja e paqes dhe qetësisë pas stuhive të mëdha, si dhuna emocionale e fizike dhe traumat e së kaluarës, ndërthuren me tradita të tilla si Totem i kaluar në breza, së bashku me Kanunin dhe zakonet që shpesh promovojnë pabarazinë, duke u mbartur ende si mbetje të së kaluarës për brezat e rinj të grave dhe burrave kosovarë.



“Totem and Taboo” is an experimental tandem of stories told through the combination of dance, acting, song and humor, suggesting that life is challenged in various forms and we are the ones who give it color.

Finding peace and tranquility after major storms, such as emotional and physical violence and the traumas of the past, are intertwined with traditions such as the Totem passed down through the generations, along with the Kanun and customs that often promote inequality, still carried as remnants. of the past for the younger generations of Kosovar women and men.

CAST :

**DONIKË AHMETI, QËNDRESA KAJTAZI, ISMAIL KASUMI,
EDLIR GASHI, KALTRINË ZENELI, MIKEL MARKAJ,
ZHANETA XHEMAJLI, BLERTA GUBETINI**





CAST :

SAKALAS UZHDAVINYS
VIDMANTAS FIJALKAUSKAS
MARTIN KUSHI - NË VIOLINÇELË / CELLO

Të përpiqesh për të hequr dorë nga dashuria është njëlloj si të mohosh vetë ekzistencën dhe origjinalitetin e saj.

Personazhi i Krapp-it, ashtu si edhe shumë personazhe të tjera të Beckett-it, është në përpjekje të vazhdueshme për të hequr dorë nga bota dhe dashuria, duke kërkuar të arrijë atë që është e pamundur, të ekzistojë pa praninë e njerëzimit dhe t'ia mbathë nga hapësira. Në të njëjtën kohë dëshiron të qëndrojë aty, prandaj vazhdon t'i rikthehet frazës “Më lër të hyj” - duke u kthyer në përvojën e fundit kur shpirti i tij është zhytur në shpirtin e saj - në atë moment kur ka ndodhur ai bashkim ekzistencial.

Çka mund të duket fillimisht e pakuptimtë dhe absurde për publikun në veprat Beckett-it, në fund rezulton të jetë kuptimi i vetëm që është ende i mundur në univers.

INSIDE OF ME IS COMPLETELY ANOTHER FIRE
BRENDA MEJE ĒSHTĒ NJĒ ZJARR TJETĒR

LITHUANIA

PRODUCTION / VILNIUS CITY CULTURE PROJECTS
AUTOR / AUTHOR / S. BECKETT

REGJISORE / DIRECTED BY SAULIUS VARNAS

SKENOGRAF / SET DESIGN / LAURA LUIŠAITYTĒ
NRIČIMI / LIGHT DESIGNER - AUDRIUS JANKAUSKAS
AUDIO / ZĒRI / FAUSTA PILKAITĒ - DOMANTAS KUTKAITIS
OPERATOR VIDEO / VIDEO OPERATOR / VIDMANTAS FIJALKAUSKAS



Trying to give up love is like denying its very existence and originality.

Krapp's character, like many of Beckett's other characters, constantly striving to give up the world and love, seeking to achieve what is impossible, to exist without the presence of humanity and to escape from space.

At the same time he wants to stay there, so he keeps coming back to the phrase "Let me in" - returning to the last experience when his soul is immersed in her soul - the moment that existential union took place.

What may seem initially meaningless and absurd to the public in Beckett's works, in the end turns out to be the only meaning that is still possible in the universe.

II WOKE UP WITH NO VOICE / U ZGJOVA PA ZË

TURKEY

PRODUCTION / BU YAPIM, INSTANMBUL
AUTOR / AUTHOR / AMY NOSTBAKKEN & NORAH SADAVA

REGJIA / DIRECTED BY TAMER LEVENT

KOREOGRAFIA / CHOREOGRAPHY / UTKU DEMIRKAYA
MUZIKA / MUSIC / BATINHAN ALTUN
KOSTUMET / COSTUME DESIGNER / FATOŞ AYDOĞDU
NDRICIMI / LIGHTING DESIGN / GÖKHAN DAVULCU



Zëdhënësja është një shfaqje e shkruar për të drejtat e grave që kanë vuajtur hapur ose fshehurazi shtypjen. Janë ato gra të cilat nuk janë në gjendje të shprehen për shkak të frikës dhe kufizimeve të ndryshme që u imponohen nga shoqëria, të heshtura, të dhunuara, madje edhe të vrara me gjak të ftohtë. Kasandra, me qëndrimin e saj rebel dhe sfidues, dëshiron të dëshmojë se një shoqëri ku gratë mund të gjejnë zërat e tyre dhe të flasin hapur është e mundur.



CAST:

**BURCU GÖREK
NUR DILARA GÜL**

“Uyandıđımda Sesim Yoktu “ (Mouthpiece) is a play written for the rights of women who overtly or covertly suffered oppression, women who are unable to express themselves because of various fears and limitations imposed on them by the society, silenced, battered, even killed in cold blood. Cassandra, with her rebellious attitude and defiance, wants to prove to us that a society where women can find their voices and express themselves is possible.

Tematikisht interesante, kjo komedi është shkruar duke u bazuar në një njohje të thellë të mentalitetit të qyteteve të vogla. Biseda e pesë personave në hollin e pritjes së një stacioni treni, ku zbulohen pothuajse të gjitha “sekretet” e jetesës në një qytet provincial. Edhe pse mund të duket e ekzagjeruar në mënyrë komike, pikërisht për shkak të vërtetësisë së dukshme, kjo bisedë ngrihet në nivelin e një imazhi metaforik jo vetëm të një mjedisi, por edhe të të gjithë vendit tonë!

- Dr. Rashko Jovanović

CAST:

**ISIDORA RAJKOVIĆ, IVAN VIDOSAVLJEVIĆ,
NENAD VULEVIĆ, SANJA MATEJIĆ, DRAGAN
STOKIĆ, DRAGOSLAV TANASKOVIĆ**



CRYING AGAIN, THIS TIME FROM HAPPINESS DUKE QARË PËRSËRI, KËTË HERË NGA LUMTURIA

SERBIA

PRODUCTION / KNJAŽEVSKO-SRPSKI TEATAR
AUTOR / AUTHOR / NOVICA SAVIĆ

REGJIA / DIRECTED BY DRAGAN JAKOVLJEVIĆ

SKENOGRAF / SET DESIGNER / MILIVOJE ŠTULOVIĆ
KOMPOZITOR / COMPOSER / DRAGOSLAV TANASKOVIC
KOSTUMET / COSTUME DESIGNER / JELENA JANJATOVIĆ
NDRICIMI / LIGHTING DESIGN / SASA RADIVOJEVIĆ
GRIMI / MAKE UP ARTIST / MARIJA KURĆUBIĆ

Thematically interesting, this comedy is written based on a deep knowledge of the mentality of small towns. The conversation of five people in the waiting hall of a train station, where almost all the “secrets” of living in a provincial city are revealed. Although it may seem comically exaggerated, precisely because of the apparent truth, this conversation rises to the level of a metaphorical image not only of an environment, but also of our entire country!

- Dr. Rashko Jovanović



NOCTURNE MBI HISTORITE TONA NOCTURNE ABOUT OUR HISTORY

ALBANIA

PRODUCTION / 3AT DANCE COMPANY

IDEJA, KONCEPTI DHE KOREOGRAFIA ARTAN IBËRSHIMI

AS.KOREOGRAF ALTIN GEGA / ASSISTANT CHOREOGRAPHER / ALTIN GEGA



Histori personale individësh që ndërthuren mes tyre në një realitet human, duke reflektuar ndjesitë e zhgënjimit, dhimbjes, protestës, frikës ndaj të panjohurës, pasionit etj. Çdo histori individuale shpërfaqet si një derivim i anës sociale apo psikologjike të shoqërisë njerëzore. Çdo ngjarje e dikujt sot mund të përjetohet nesër nga dikush tjetër. Konfliktet personale përfshijnë jo vetëm individin por gjithë komunitetin ku ai frymon.

Në tërësinë e saj vepra transmeton domosdoshmërinë e reagimit dhe ndjeshmërinë e shoqërisë humane ndaj problematikave të saj.



CAST:

**DANJA KOVACI, UELSI ALUSHI,
SADIK PEÇI, HALIT BACINOFSKI,
ERION VATNIKA, ERTA SINA,
SARA DYRMISHI, KLAUDJA JAZE**

Nocturne on our stories” Personal stories of individuals intertwined in a human reality, reflecting feelings of disappointment, pain, protest, fear of the unknown, passion, etc. Each individual story unfolds as a derivation of the social or psychological side of human society. Anyone’s event today can be experienced tomorrow by someone else. Personal conflicts involve not only the individual but the entire community where he breathes.

In its entirety, the work conveys the necessity of reaction and the sensitivity of human society to its problems.



CAST:

**BOJANA MALINOVSKA, JULIJA MILACIC
ANA VUCKOVIC, MOMO PICURIĆ
MILOS PEJOVIC, ZORAN VUJOVIC
JOVAN KRIVOKAPIC, PETAR NOVAKOVIC
DEJAN IVANIC, MILIVOJE PICURIC**

“Mund të thuhet se kjo është një shfaqje për pamundësinë e dashurisë, por edhe për kënaqësitë e pakapshme që përfshijnë kërkimin e saj, pa të cilat jeta jonë në këtë planet do të ishte më e zbrazët dhe e pavlerë. Përgjithësisht këto “Tri Motra” kanë disa shtresa të dendura kuptimi që na sfidojnë për zhvillimin e kërkimeve poetike dhe filozofike, për të ballafaquar mendimet mbi ekzistencën dhe vuajtjet, për rëndësinë e punës, për vetminë dhe kapërcimin e saj, për ndikimin e fatit, si dhe mbi mundësitë për të mposhtur kryeneçësinë personale.”

- Ana Tasic

THREE SISTERS / TRE MOTRAT

PRODUCTION / FIAT - GRAD TEATAR BUDVA
ALTERNATIVE THEATRE & MUNICIPALITY THEATER BUDVA
AUTOR / AUTHOR / A. P. ČHOV

REGJIA / DIRECTED BY ANA VUKOTIĆ, SLOBODAN MILATOVIĆ

SKENOGRAF / SET DESIGN / ENES DEARI
KOMPOZITOR / COMPOSER / IVAN MAROVI
KOSTUMET / COSTUMES / LINA LEKOVIĆ
NRIČIMI / LIGHT DESIGNER / MILI MALOVIĆ
KOREOGRAFIA / CHOREOGRAPHY / SONJA VUKIĆEVIĆ
GRIMI / MAKE UP ARTIST / MILKA STOJANOVIĆ

MONTE NEGRO

“It can be said that this is a show about the impossibility of love, but also about the elusive pleasures that include its search, without which our life on this planet would be more empty and worthless. In general, these “Three Sisters” have several dense layers of meaning that challenge us to develop poetic and philosophical research, to confront thoughts on existence and suffering, the importance of work, its loneliness and overcoming, the impact of fate, as and on opportunities to defeat personal stubbornness.”

- Ana Tasic



NDRYSHIMET ENIGMATIKE ENIGMATIC VARIATIONS

ITALY

PRODUCTION / MEDIASCENA

AUTORI / AUTHOR / ÉRIC-EMMANUEL SCHMITT

REGJISOR / DIRECTED BY EMILJANO PALALI

SKENOGRAF / SET DESIGN / RANIERO CANE

KOSTUMET / COSTUMES / EMILJANO PALALI

Një “thriller” psikologjik, një lojë ndjenjash shahu mes dy burrave që konkurrojnë me njëri-tjetrin në kërkim të së vërtetës, mbërrin në skenë nga pena e dramaturgut Eric - Emmanuel Schmitt. Ata janë shkrimtari fitues i çmimit “Nobel”, Abel Znorko (Salvatore Curaba), i cili ka zgjedhur të izolohet nga bota dhe gazetari Erik Larsen (Endrit Ahmetaj), që dëshiron të rrëmbejë një intervistë ekskluzive prej tij. Ashtu si në një thriller ndjenjash të pikëzuara nga kthesa dramatike, dy personazhet përplasen në një alternim të mizorisë dhe butësisë, të ironisë së mprehtë dhe emocioneve të thella: një intervistë që së shpejti kthehet në një zbulim interesant të së vërtetës në heshtje.

“Variacionet Enigmatike” është një përballje e paharrueshme, ku publiku përfshihet në një shkëmbim të vazhdueshëm dialektik midis iluzionit e shmangies dhe njëkohësisht është jashtë lojës. “A jemi të sigurt se e vërteta zbulon më shumë sesa gënjeshtra?”





CAST:
SALVATORE CURABA
ENDRI AHMETAJ

A psychological “thriller”, a game of chess feelings between two men competing with each other in search of the truth, arrives on stage from the pen of playwright Eric - Emmanuel Schmitt. They are Nobel Prize-winning writer Abel Znorko (Salvatore Curaba), who has chosen to isolate himself from the world, and journalist Erik Larsen (Endrit Ahmetaj), who wants to snatch an exclusive interview from him.

As in a thriller of feelings spotted by dramatic twists, the two characters collide in an alternation of cruelty and gentleness, sharp irony and deep emotion: an interview that soon turns into an interesting revelation of the truth in silence.

“Enigmatic Variations” is an unforgettable confrontation, where the audience is involved in a constant dialectical exchange between the illusion of avoidance and at the same time is out of the game. “Are we sure that truth reveals more than lies?”



CAST:

**HELIDON FINO,
EGLA CENO, DONALD SHEHU,
XHULIANO BRISKUALGIONA AGA, ELONA MAMO
MARIO ELEZI, DHIMITER TOPUZI,
EGLA CENO**

ARTEMISS MUÇA, KLEA BYLYKU, ANISA DERVISHI, RIANA BALLA, SILVIA SINA, ANXHELA BERISHA



NJË MADAM NGA ARGJENTINA A LADY FROM ARGENTINA

ALBANIA

PRODUCTION / TEATRI SKAMPA ELBASAN
AUTOR / AUTHOR / TOMAS BRAND

REGJIA / DIRECTED BY ADONIS FILIPI

SKENOGRAF / SET DESIGNER / SOKOL SEJDINI
KOREOGRAFIA / CHOREOGRAPHY / ARTAN F. IBERSHIMI
SELEKTOR MUZIKE / MUSIC DESIGNER / ADONIS FILIPI
KOSTUMET / COSTUME DESIGNER / SOFI KARA
NDRICIMI / LIGHTING DESIGN / HELIDON GREMI
ZERI / SOUND / MET ÇERA



Vonesa e një “Madame të shumëpritur” sjell për spektatorët një shfaqje gazmore të mbushur plot situata absurde, ngjarje të pamundura, surpriza dhe aksion duke provokuar argëtim, gëzim dhe hare. Një komedi me nuanca të theksuara muzikale, me një gjuhë atraktive shprehëse relevante, ku veç batutave, gjuha e lëvizjes, gjesti e tingulli, si dhe e gjithë ikonografia e “korit” ndihmon padyshim në përcjelljen e një estetike bashkëkohore.

-Gazeta “Sot”

The delay of a “long-awaited Madame” brings to the spectators a hilarious show full of absurd situations, impossible events, surprises and action provoking fun, joy and happiness.

A comedy with strong musical nuances, with an attractive relevant expressive language, where in addition to jokes, the language of movement, gesture and sound, as well as the whole iconography of the “choir” definitely helps to convey a contemporary aesthetic.

-Newspaper “Sot”

MARIAGE / MARTESA

PRODUCTION / TEATRI "ALEKSANDER MOISIU" DURRES
AUTOR / AUTHOR / A. P. ČEHOV

REGJIA & ADAPTIMI / DIRECTED & ADAPTATION BY DRIADA DERVISHI

KOREOGRAFIA / CHOREOGRAPHY / ELTON ÇEFA
KOSTUMET / COSTUME DESIGNER / D. DERVISHI, A.MUÇA



“Tragjik pa dashje”, “Ariu”, “Propozimi” dhe “Martesa”, katër pjesë me një akt të dramaturgut Anton Çehov, vijnë të gjitha në skenë të shkruara në një lojë gazmore që përqendrohet te një martesë e madhe ku mund të gjesh gjithçka: nga nusja që do të argëtohet - te një dhëndër dorështrënguar - një burrë i lodhur nga bashkëshortja - si dhe një vejushë e cila është betuar të mbajë zi përjetë dhe që ironikisht bie në dashuri me huadhënësin e burrit të saj të ndjerë...

Një spektakel vezullues, plotë dritë.

-Josif Papagjoni

“Unintentionally Tragic”, “Bear”, “Proposal” and “Marriage”, four parts with an act by playwright Anton Chekhov, all come out on stage merged into a hilarious game that focuses on a big wedding where you can find everything: from the bride who will have fun - to a stingy groom - a man tired of his wife - as well as a widow who has vowed to mourn forever and who ironically falls in love with her late husband’s lender. .

A bright spectacle, full of light. - Josif Papagjoni

CAST:

**ANDIA XHUNGA, AMOS ZAHARIA
ADELINA MUÇA, GENTIAN ZENELAJ
ALESIA XHEMALAJ, JAHO GUMAJ
MIMOZA MARJANAKU, GJERGJI DOÇI,
SUELA BAKO XHEJNI FAMA**





CAST :
XHULIANO BRISKU



An extremely exciting story - in a very attractive presentation about man and destiny, by the prominent Romanian author Doru Motoc.

"Are we part of what we become, or do we become what we are?" Is fate the lord of everything?

A game without solutions ...?"

The saxophonist Xhuliano faces in a challenging whim with fate, equipped with the only weapon he has in his hand: the his soul and the imagination.

BLUZ PËR ALTO SAX / BLUES PER ALTO SAX

ALBANIA

LAB THEATER A.T.K, TIRANE, ALBANIA
AUTOR / AUTHOR / DORU MOTOC

REGJIA / DIRECTED BY ADONIS FILIPI

KOSTUMET / COSTUME DESIGNER / SOFI KARA
SELEKTOR MUZIKE / MUSIC DESIGNER / ADONIS FILIPI



Një histori e jashtëzakonshme emocionuese - në një paraqitje tejet tërheqëse rreth njeriut dhe fatit, nga autori i shquar rumun Doru Motoc.

*“A jemi pjesë e asaj çka bëhemi, apo bëhemi çka jemi?
A është fati zoti i gjithçkaje? Një lojë pa zgjidhje...?”*

Saksofonisti Xhuliano përballlet në një trill sfide me fatin, i pajisur me të vetmet armë që ai ka në dorë: shpirtin dhe imagjinatën.

©UR YUNUS / YUNUSI YNË

TURKEY

PRODUCTION / TURKISH STATE THEATERS / ANKARA STATE THEATRE
AUTOR / AUTHOR / SÖNMEZ ATASOY

REGJIA / DIRECTED BY MUSTAFA KURT

SKENOGRAF / SET DESIGNER / HAKAN DÜNDAR
MUZIKA / MUSIC / NEDİM YILDIZ
KOSTUMET / COSTUME DESIGNER / FUNDA KARASAÇ
NDRICIMI / LIGHTING DESIGN / MUSTAFA BAL



Yunus Emre është një mendimtar dhe poet i madh turk dhe një nga gurët e themelit të gjuhës dhe civilizimit turk. “700 vjetori i vdekjes së Yunus Emre” është përfshirë në listën e përkujtimeve dhe përvjetorëve nga Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) për këtë vit.

“Yunusi ynë” i shkruar me një interpretim bashkëkohor, i drejtohet të gjithë njerëzimit pa varësisht gjuhës, fesë dhe racës. Me një turqishte të pastër shfaqja shpjegon konceptet e dashurisë për njeriun dhe natyrën, tolerancën, vëllazërinë dhe paqen, duke i reflektuar këto nocione përmes trilogjisë “Dje, sot dhe nesër”.

“Le të duam, të na duan, bota i përket çdokujt.”

Yunus Emre is a great Turkish thinker and poet and one of the cornerstones of the Turkish language and civilization. The “700th anniversary of the death of Yunus Emre” is included in the list of memorials and anniversaries by the United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO) for this year.

“Our Yunus” written with a contemporary interpretation, addresses all humanity regardless of language, religion and race. In pure Turkish, the play explains the concepts of love for man and nature, tolerance, brotherhood and peace, reflecting these notions through the trilogy “Yesterday, today and tomorrow”.

“Let us love, let them love us, the world belongs to everyone.”

**CAST:
ALPAY ULUSOY**



In Memoriam



Bekim Lumi
1967 - 2018

Një nga regjisorët më të shquar të teatrit avantgard, i vlerësuar në fushën e teatrit në Kosovë dhe më gjerë, profesor në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Kryeredaktor i revistës teatrale “Loja”.

Ai është vlerësuar me Mirënjohje Speciale “Sound of MESS” me shfaqjen “Këmisha e gjakut”, Festivali Ndërkombëtar i Teatrit MESS, Sarajevë (Bosnjë e Hercegovinë). Në vitin 2011 ka marrë çmimin “Shfaqja më e mirë muzikore” për shfaqjen “Çifti Martin”, Festivali Ndërkombëtar i Teatrit Kamertal – Vratza (Bullgari). Çmimi “Shfaqja më e mirë”.

Ndër veprat e realizuara:

Teatri Laborator “Loja”, Prishtinë 2010 – William Shakespeare, “Këmisha e gjakut” (bazuar në tragjeditë “Makbethi”, “Rikardi III” dhe “Hamleti” të W. Shakespeare-it;


Teatri Laborator “Loja”, Prishtinë 2008 – Eugene Ionesco, “Çifti Martin”;

Teatri Kombëtar i Kosovës, Prishtinë 2006 – Federico Garcia Lorca, “Shtëpia e Bernarda Albës”; 2005 – A. P. Çehov, “Arushani” & “Fejesa”; 2003 – Slavomir Mrozek, “Galani”, Teatri “Dodona”; Prishtinë 2002 – Eugene Ionesco, “Mësimi”; 2000 – “Kësulëkuqja në botën e minave” (shfaqje me kukulla); Teatri “Loja”, Mynih (Gjermani) 1999 – adaptim nga A. P. Çehov “Pëgruan dhe tokën e jap edhe kokën” etj .

One of the most prominent directors of avant-garde theater, evaluated in the field of theater in Kosovo and beyond, professor at the Faculty of Arts at the University of Prishtina. Editor-in-chief of the theatrical magazine “Loja”.

He was awarded a Special Acknowledgment “Sound of MESS” with the play “Blood Shirt”, MESS International Theater Festival, Sarajevo (Bosnia and Herzegovina). In 2011 he received the award “Best Musical Performance” for the play “Martin Couple”, International Festival of Kamertal Theater - Vratza (Bulgaria). “Best Performance” Award – Performance.

Laboratory Theater “Loja”, Prishtina 2010 - William Shakespeare, “Shirt of Blood” (based on the tragedies “Macbeth”, “Richard III” and “Hamlet” by W. Shakespeare, , 2008 - Eugene Ionesco, “Martin Couple”, National Theater of Kosovo, Prishtina 2006 - Lorca, “Bernarda Alba House”, 2005 - AP Chekhov, “Bear “ & “Engagement”, 2003 - Slavomir Mrozek, “Galani”, “Dodona” Theater, Prishtina 2002 - Eugene Ionesco, “Lesson”, 2000 - “Little Red Riding Hood in the World of Explosive Mines” (puppet show). “Theater” Theater, Munich (Germany) 1999 - adaptation by A. P. Chekhov “For the woman and the land I give my head” etc.



Slobodan Milatović
1952 – 2019

Ai ka bërë më shumë se 70 shfaqje teatrore. Ai është themeluesi i Teatrit Dodest, ku punoi si drejtor artistik për 25 vjet. Disa nga shfaqjet e Milatoviçit janë “Prometeu i lidhur me zinxhirë”, “Drita e mikrokozmosit”, “Kurora malore”, “Fëmijët në parlament”, Miss Julia, “Hamlet”, “Teuta”. Ai gjithashtu performoi për CNP, Teatri Mbretëror, KC Kotor, Teatri Nikšić, Teatri i Qytetit PG dhe në trupa joformale. Ai është themeluesi i festivalit FJAT, FIAT, Bar Chronicle, PG Summer, Festivali i Aktorëve në NK, Teuta në Kotor. Ai është bashkë-shkrimtar i filmit “Mrekulli e paparë” dhe skenarist i filmit “Kurorë mali”. Ai gjithashtu ka drejtuar rreth 30 drama radio. Slobodan Milatović ka statusin e një krijuesi meritues të Malit të Zi.

He has done more than 70 theater plays. He is the founder of the Dodest Theater, where he worked as an artistic director for 25 years. Some of Milatović’s plays are “Chained Prometheus”, “Light of the Microcosm”, “Mountain Wreath”, “Children in Parliament”, Miss Julia, “Hamlet”. He also performed for CNP, Royal Theater, KC Kotor, Nikšić Theater, City Theater PG and in informal troupes. He is the founder of the festival FJAT, FIAT, Bar Chronicle, PG Summer, Festival of Actors in NK, Teuta in Kotor. He is the co-writer of the film “Unseen Miracle” and the screenwriter of the film “Mountain Wreath”. He has also directed about 30 radio dramas.




Luran Ahmeti 1974 - 2021

Një nga aktorët e shquar shqiptar nga Maqedonia e Veriut. Në vitin 1999 diplomoi në Fakultetin e Artit Dramatik nga Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, Shkup. Në karrierën e tij 25 vjeçare, me rolet e shumta në shfaqet teatrale në Teatrin Shqiptar, Shkup la gjurmë në artin dramatik shqiptar dhe shtoi vlerë në kulturën shqiptare. Luajti në filma artistik dhe në seriale të njohura rajonale e botërore.

Ka interpretuar me nivel të lartë në mbi 14 vepra teatrore si “Eshtrat që vijnë vonë” Edipi Mbret, Repriza e lirisë, Nënkresbami, Akuariumi, Kafeneja në udhëkryq, Alegreto Albania, Paraja, Gjymtimi, Darka e Thërrimeve, Vdekja e Dantonit, Metoda, Bregu i pikëllimit etj. I vlerësuar me mjaft cmime kombëtare e nderkombëtare për realizimet e tij artistike.

One of outstanding Albanian actor from northern Macedonia. In 1999 he graduated from the Faculty of Dramatic Arts at the University of St. Cyril and Methodius, Skopje. In his 25-year career, with numerous roles in theatrical performances at the Albanian Theater, Skopje left its mark on Albanian dramatic art and added value to Albanian culture. He starred in feature films and popular regional and world series.

He has performed in over 14 plays such as “Bones that come late” King Oedipus, Repetitions of freedom, Nënkresbami, Aquarium, Cafe at the crossroads, Alegreto Albania, Paraja, Mutilation, The Dinner of Crumbs, The Death of Danton (2018), Method, Shore of Sorrow etc. Awarded with many national and international awards for his artistic achievements.



Shpetim Shemili 1945 -1994

Figura e artistit të nderuar e të talentuar, me vlera mjaft të spikatura interpretative në nivel kombëtar. Ai i ka ofruar artit të skenës një galeri të pasur e të larmishme karakteresh të realizuara me mjeshtëri në skenën e Teatrit “Skampa” dhe atë kinematografike. Janë mbi 60 role në teatër dhe 12 në kinematografi. Krijimtaria e tij është vlerësuar dhe nderuar me mjaft çmime.

Mbresëlënëse janë realizimet artistike të “Njeriu që pa vdekjen me sy”, “Udha e Zavalinajve”, “Sinjalet e natës” “Familja e peshkatarit”, “Lulet e shëgës”, “Engjëjt e skëterrës”, “Sa shumë gjethë të thata atë vjeshtë”, “Nëpërka” etj.

The figure of the honored and talented artist with very prominent interpretive values at the national level. He has brought to the art of the stage a rich and diverse gallery of characters masterfully realized on the stage of the Skampa theater and in the cinematographic one. There are over 60 roles in theater and 12 in cinematography. His creativity has been appreciated and honored with many awards.

Impressive artistic realizations of “The man who saw death with his eyes”, -, “The way of the Zavalinaj”, -, “Night signals”, -, “The fisherman’s family”, -, “Pomegranate flowers” “Angels of hell”, “ How many dried leaves that fall”, “ Vipers” etc.



MBYLLJA E DASHURISE THE CLOSURE OF LOVE

AUTORI / AUTHOR / PASCAL RAMBERT
REGJISOR / DIRECTED BY ERIC VIGNER

CAST: LUIZA XHUVANI , VASJAN LAMI



NGA SYTE E KLLOUNIT FROM THE CLOWN'S EYES

CIRKU KOMBETARE / NATIONAL CIRCUS
REGJISOR / DIRECTED BY ALKETA HAXHIU


CAST: ULJAN XHANI - MJESHTER CIRKU
XHEJMS KODRA- MJESTER CIRKU
GERALD SHIMA- KLLOUNI
ERIS HOXHA - AKROBATE
IBRAHIM SELISHTA-AKROBAT
LOREDANA DUSHKU-AKROBATE
SABINA TROSHKU- AKROBATE
ARMELA BUSHGJOKAJ- AKROBATE



BALLKANCOVIDIZËM

REGJISOR / DIRECTED BY SABEDIN SELMANI

CAST: AJSHE USEINI



**DOKUMENTAR DEDIKUAR
ARTISTIT TE SHQUAR
MINELLA BOROVA**

**DOCUMENTARY DEDICATED TO
THE FAMOUS ALBANIAN ARTIST
MINELLA BOROVA**



FRIGORIFERI / FREEZER

**TEARTI 'KLLAPA' - KOSOVE - KOSOVO
AUTOR DHE REGJISOR / WRITTEN & DIRECTED BY
NASER SHATROLL**

**CAST:
QENDRESA KAJTAZI
FLORENT SALIHU**



**DIALOG PER TE DJESHMEN,
TE SOTMEN, TE ARDHMEN
DIALOGUE FOR YESTERDAY,
TODAY, THE FUTURE**

**IDEA, KONCEPTI DHE KOREOGRAFIA
IDEA, CONCEPT AND CHOREOGRAPHY
ARTAN IBERSHIMI**

**DANCERS:
BLERTA FANAJ, DENADA KERCIKU
KLAUDJA JAZEXHI, BESJANA BYTYCI
STIN CACE, UESLI ALUSHI
SADIK PEÇI, KRISTJAN KAVALLI
HALIT BACINOFKI, ELGITA PLAKU
DANJA KOVACI**



JUL CEZARI / JULIUS CAESAR

**TEATRI KOMBETAR EKPERIMENTAL
AUTORI / AUTHOR / WILLIAM SHAKESPEARE**

**CAST:
ROMIR ZALLA, ALFRED TREBICKA,
VIN BEJLERI, AMOS MUJZAHARIA,
ALERT ÇELOALIAJ, ERMIRA HYSAJ,
ILIRDA BEJLERI, ADRIANA TOLKA,
ILIA KAÇI, MATEO DERVISHAJ,
ENDRIÇELA, ENJËLL HOXHA,
ENEA NIKA, ANXHELO SHKRELI**



**LOJRA NE OBORIN E PASEM
BACKYARD GAMES**

**KOMPANIA TEATRORE MAM
AUTORI / AUTHOR / EDNA MAZYA
REGJISOR / DIRECTED BY EMA ANDREA**

**CAST:
SUELA BAKO, ENISA HYSAJ,
MATIA LLUPA, ARTEMISA KUSI,
ERMIR HOXHAJ, ERMIR JONKA,
PAOLO KADILLARI, NOEL KOKOMANI
ROSELLA PELLICCIOTI**



LIBRARIA E PERJETESHME ETERNITY BOOKSTORE

AUTORI / AUTHOR / SABAHATTIN KUDRET AKSAL
REGJIA / DIRECTED BY MUSTAFA KURT

CAST:
ÖZGÜR DENİZ KAYA
ORIDA YILDİRAN
GIZEM YÖNEL



DERA / THE DOOR

AUTOR / AUTHOR / NASER SHATROLI
REGJIA / DIRECTED BY ADONIS FILIPI

CAST:
XHULIANO BRISKU



ZYRTARISH BEQARE OFFICIALLY SINGLE


TEATRI SKAMPA
AUTOR / AUTHOR / ALIL VARDAR
REGJISORE / DIRECTED BY ARMAND BORA

CAST:
GENTIAN ZENELAJ
EGLA CENO
ILIRDA BEJLERI
EVIS SERANI



STAF / STAFF

Adonis Filipi	Drejtor Artistik i Festivalit / Artistic Director of Festival 'Skampa
Kliton Kapaj	Drejtor i Qëndrës Artit / Director of Art Center, Elbasan
Geris Filipi	As. Drejtor i Festivalit / As. Director of Festival
Blendi Gremi	Kordinatore / Coordinator of Festivalit
Xhuliano Brisku	Kordinatore / Coordinator of Festivalit
Klejda Plangarica	Media
Elona Mamo	Coordinator of Festivalit Kordinatore
Zhaneta Ruçaj	Bashkpuntore / Collaborators of Festival
Brunilda Kola	Marketing
Cen Mullajonuz	Bashkpuntor / Collaborators of Festival
Doru Motoc	Bashkpuntor / Collaborators of Festival (Romania)
Renato Sotiriadhi	Bashkpuntor / Collaborators of Festival (Russia)
Romano Foddai	Bashkpuntor / Collaborators of Festival (Italy)
Robert Germay	Bashkpuntor / Collaborators of Festival (Belgium)
Klodian Shahinaj	Inspektor skene / Stage manager
Helidon Gremi	Ndricimi / Lighting Technician
Met Çera	Zëri / Sound Technician



23
EDITION
TEATER III
THEATRE THREE



WWW.SKAMPAFESTIVAL.COM



[SKAMPAFESTIVAL](https://www.facebook.com/SKAMPAFESTIVAL)



INFO@SKAMPAFESTIVAL.COM



[Skampa_Theatre_Festival](https://www.instagram.com/Skampa_Theatre_Festival)